



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2024:313835
Datë: 20.01.2025
Numri i dokumentit: 06729329

C.nr.1114/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtaren Lirika Sylaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E. B nga fshati P, Komuna e Istogut, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Florije Curri Kryeziu - avokate në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, sipas objektit të kontestit kompensim i diferencës në pagë mbi bazën e kualifikimit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 20.01.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- Për shkak të pa dëgjueshmërisë/mosbindjes -

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit E. B, ashtu që, DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, në emër të kompensimit të diferencës së pagave të pa paguara mbi bazën e kualifikimit në punë, për periudhën kohore nga data 19.04.2022 deri me 06.02.2023, (9 muaj x 84.56 €), për kualifikimin Bachelor në vlerë të 27 % të pagës bazë, t'ia paguajë shumën në vlerë prej 761.04 Euro, të gjitha këto së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë, gjegjësisht data 06.11.2024, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, t'ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 125 Euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit E. B dhe atë shumën prej 169.16 Euro përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur padi me datë 06.11.2024, të kundër paditurës Komuna e Istogut – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensim e pagave mbi bazën e kualifikimit.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë 14.11.2024, të cilin e paditura e ka pranuar me datë 18.11.2024 (e cila është konfirmuar përmes fletë kthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës). Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Themelësia e kërkesëpadisë për paditësin E. B doli nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht nga: kontrata 05 me numër 11.../13 e datës 11.10.2013 e lidhur në mes të paditurës dhe paditësit nga e cila vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura si mësimdhënës i historisë në Sh.f.m.u “Fan S. Noli” në Ll. B me kontratë në kohë të pacaktuar, diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik për njohjen e titullit "profesor i historisë", licenca me numër 100024413 e lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nga e cila vërtetohet se paditësi ka fituar licencën e mësimdhënësit të karrierës si dhe lista pagave nga e cila vërtetohet paga bazë e paditësi në vlerë prej 421.20 Euro.

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të mbështetjes së kërkesëpadisë, Gjykata iu referua Vendimit Nr.01/33, të datës 29.08.2008, të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ku në pikën 3 të këtij Vendimi shprehimisht përcaktohet që: *“Ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillor dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kritereve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës”*. Pika 4 e të njejtij vendim përcakton që: *“Mësimdhënësit, drejtoret (zëvendësdrejtoret) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur: Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagesës bazë prej 27%; Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoratë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Në kuadër të zbatimit të këtij vendimi,

së fundmi gjykata iu referua edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A-Su.A, 214/2023, të dt. 09.10.2023, specifikisht pikës I të këtij Mendimi, ku përcaktohet: “Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim që paditësve t’iu paguajë kompensimin mbi bazën e kualifikimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), ku është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kritereve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.

Nga provat e vlerësuara, gjykata provoi se, e paditura nuk i ka kompensuar paditësit në tërësi pagën sipas përqindjes mbi bazën e kualifikimit shkollor të tij, përkatësisht me diplomë universitare të nivelit bachelor. Konkretisht nga listat e pagave u provua fakti se e paditura në emër të kualifikimit paditësit E.B i ka paguar shumën prej 29.16 Euro, ndërsa, është dashur që të njëjtit t’ia paguaj 27% të pagës bazë [421.20 Euro] në vlerë prej 113,72 Euro, duke i mbetur kështu paditësit në detyrim për pjesën tjetër në vlerë prej 84.56 dhe atë për 9 muaj, e në vlerën e tërësishme si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me pjesën refuzuese në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, vendosi pas analizimit dhe përlogaritjes së periudhës së kërkuar për kompensim dhe muajve të kërkuar me kërkesëpadi, e që u konstatua se paditësit i takon kompensimi prej 9 muajve e kjo pasi që muaji 04 i vitit 2022 i është kompensuar të njëjtit me aktgjykimin e kësaj gjykate C.nr.494/21 të datës 26.09.2024, ndërsa, nga muaji 05 i vitit 2022 e deri me 06.02.2023 janë gjithsej 9 muaj për kompesim e jo 11 muaj ashtu siç është kërkuar me kërkesëpadi, prandaj gjykata e refuzoj pjesën tjetër si të pabazuar.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (06.11.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Avokatëve të Kosovës ashtu që

lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet: 104 euro për përpilimin e padisë dhe 21 Euro për taksën gjyqësore.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 150 par.1 pika a, b, dhe c të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG,
Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni për Çështje Civile

Gj y q t a r j a
Lirika Sylaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.